



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.C.nr.6244/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi, dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve T. Th., A. Th., O. Th., O. Th., L. Th. dhe L. Th. të gjithë nga Vushtrria të cilët me autorizim i përfaqëson avokati Blerim Syla nga Prishtina, kundër të paditurit KS. "Elsig" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Veton Bublaku, për shkak të kompenzimit të dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.998/2014 datë 13.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e paditësve T. Th., A. Th., O. Th., O. Th., L. Th. dhe L. Th. të gjithë nga Vushtrria. PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.998/2014 datë 13.09.2018, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në ri procedim dhe ri vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.998/2014 datë 13.09.2018, ka vendosur: REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentin e dt. 14.02.2014, në Vushtrri, ndaj të paditurit KS,, "Elsig" në Prishtinë, sipas kërkesave si vijon:

Paditësit T. Th.

Për dhimbje fizike në shumë 3.000,00€,

Për frikë në shumën, 2.500,00€,

Për ushqim të përforcuar në shumë 100,00€,

Për kujdesin nga personi tjetër në shumën, 100,00€,

Për rehabilitim në shumën 200,00€.

Paditësit L. Th.

Për dhimbje fizike në shumë 3.000,00€,

Për frikë në shumën, 2.500,00€,

Për ushqim të përforcuar në shumë 100,00€,

Për kujdesin nga personi tjetër në shumën, 100,00€,

Për rehabilitim në shumën 200,00€.

Paditëses A. Th.

Për dhimbje fizike në shumë 3.000,00€,

Për frikë në shumën, 2.500,00€,

Për ushqim të përforcuar në shumë 100,00€, Për kujdesin nga personi tjetër në shumën, 100,00€,

Për rehabilitim në shumën 200,00€.

Paditëses O. Th.

Për dhimbje fizike në shumë 3.000,00€,

Për frikë në shumën, 2.500,00€,

Për ushqim të përforcuar në shumë 100,00€,

Për kujdesin nga personi tjetër në shumën, 100,00€.

Paditëses O. Th.

Për dhimbje fizike në shumë 3.000,00€,

Për frikë në shumën, 2.500,00€,

Për ushqim të përforcuar në shumë 100,00€,

Për kujdesin nga personi tjetër në shumën, 100,00€.

Paditëses L. Th.

Për dhimbje fizike në shumë 3.000,00€,

Për ushqim të përforcuar në shumë 100,00€,

Për kujdesin nga personi tjetër në shumën, 100,00€.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjorë, paditësit kanë parashtruar për shkak të: Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësve ashtu që aktgjykimin e ankimuar ta priset dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në ri vendosje.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në padi, edhe pse e njëjta me kohë është njoftuar me ankesën e paditësve.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, në ankesa, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa e paditësve është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësit T. Th., A. Th., O. Th., O. Th., L. Th. dhe L. Th. të gjithë nga Vushtrria, me datë 03.04.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompanisë së Sigurimeve "Elsig", me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, kërkesë kjo e precizuar me parashtresën e datës 13.09.2018, të specifikuar si në parashtresë.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.998/2014 datë 13.09.2018, me të cilin ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë, mes tjerash ka arsyetuar se: Me provën e marrëveshjes jashtë gjyqësore të lidhur në mes të autorizuarve të paditësve avokatit Mexhid Syla dhe të autorizuarit të paditurit R. I. drejtor është vërtetuar faktin se ndërgjyqësit për aksidentin e shkaktuar, janë pajtuar për shumat si vijojnë, që paditësit L. Th. ti paguhet shuma 170,00€, T. Th. shuma 170,00€, A. Th. shumë 204,00€, O. Th. shuma 142,00€ O. Th. shuma 176,00€ dhe L. Th. shuma 110,00€. Si dhe shpenzimet për avokatin 215,00€.

Më tej ka arsyetuar se: Sipas marrëveshjes në fjalë me pikën 5 është pajtuar që paditësit ndaj të paditurit nuk do të ketë kurrfarë kërkesë të më vonshme. Në shumën e kompensimit janë përfshirë të gjitha kategoritë e zhdëmtimit të parapara me dispozita të LMD-së, dhe kërkesat eventuale derivative që mundë të paraqiten në të ardhmen, andaj i dëmtuari nuk ka të drejtë të kërkojë zhdëmtim shtesë po që se paraqitet në të ardhmen andaj i dëmtuari nuk ka të drejtë të kërkojë zhdëmtim shtesë. Kjo ujdë ka karakter të dokumentit përmbarues. Andaj, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, i autorizuari i paditësve dhe i padituri nuk kanë ofruar dëshmi me të cilat provohet fakti se marrëveshja nuk është ekzekutuar, kjo rrethanë nënkupton se marrëveshja jashtë gjyqësore është ekzekutuar në tërësi nga e paditura.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata vlerëson se kjo marrëveshje nuk është sulmuar nga asnjëra prej bazave juridike të punëve juridike çoftë sipas rrezikshmërisë së punëve apo të nulitetit. Me nenin 51 të LMD-së rregullohet paragrafi 1 Lidhja e kontratës nuk i nënshtrohet asnjë forme, përveç nëse me ligj është caktuar ndryshe. Par. 2. Përcaktimi me ligj, që kontrata të lidhet në një formë të caktuar vlen edhe për të gjitha ndryshimet ose plotësimet e mëvonshme të kontratës". Me nenin 54 të LMD-së rregullohet, 1. Palët kontraktuese mund të merren vesh, që forma e veçantë të jetë kusht për vlefshmërinë e kontratës së tyre. ". Andaj, palët në rastin konkret për dëmin dhe kompensimin e dëmit, kanë arritur pajtim jo gjyqësor për zgjidhje të kontestit në mesë tyre në formën e shkruar, të cilën e kanë nënshkruar me vullnetin e tyre dhe

janë pajtuar që ajo të ketë titull përmbarues e që në rastin konkret edhe e njëjta është përmbarues. Sipas kësaj marrëveshje askund nuk përcaktohet çështja e ndarjes së përgjegjësisë siç pretendon i autorizuari i paditësve në shkallës 50% me 50%, por palët janë deklaruar se nuk do të bëjnë asnjë kërkesë tjetër në lidhje me dëmin e pësuar që rrjedhë si pasojë e aksidentit të trafikut të datës 14.02.2014. sipas marrëveshjes rrjedhë se pala paditëse nuk ka provuar pretendimin e tyre se marrëveshja për zgjidhje të kontestit për dëmin e pësuar në aksidentin e datës 14.02.2014 është e pjesshme, që sikur të ishte e pjesshme, si kontaktuese të mbetet pjesa tjetër për shkallës prej 50%, krejt kjo sipas barrës së provës e në kuptim të nenit 322.1 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e kësaj çështje, vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase Aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 pika n) të LPK, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm dhe i pa ekzaminueshëm, për të njëjtin mungojnë arsyet për faktet vendimtare, në ndërkohë që edhe ato arsye të cilat janë dhënë, janë në kundërshtim me vetë dispozitivin dhe provat shkresore të lëndës. Po ashtu sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit edhe gjendja faktike në këtë procedurë nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për të cilën arsye pastaj ka ardhur edhe deri te zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Gjykata e Apelit i aprovon si të bazuara pretendimet ankimore të paditësve në lidhje me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që këto shkelje konsistojnë në faktin se aktgjykimi i ankimuar ka të meta, për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pa kjashtë i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vetë veten dhe arsyetimin e tij, kjo sepse dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar nuk është përpiluar bazuar në nenin 160 par. 3 dhe 4, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore. Në nenin 182 par. 2 pika n) lidhur me pikën o) të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore në ndër të tjera thuhet se: *“...në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit...”*. Në rastin konkret aktgjykimi është kontradiktor me vetë veten dhe me provat të cilat janë administruar, pasi që kjo vërehet se në dispozitivin e aktgjykimit.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të bazuar pretendimet ankimore të paditësve në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. gjykata e Apeli konstaton se paditësit në procedurë kontestimore kanë kërkuar kompensimin e dëmit për pjesën e 50% të përgjegjësisë dhe nuk kanë kërkuar për tërë përgjegjësinë që bie në të paditurën, kjo për faktin se të njëjtit me marrëveshje jashtë gjyqësore me nr. të lëndës 0349/14/02 të datës 110548, në pikën II janë pajtuar që kontestin ta zgjidhin me këtë marrëveshje në lartësi prej 50% të përgjegjësisë, kjo për faktin se palët ndërgjyqëse në kohën e arritjes së kësaj marrëveshje nuk kanë qenë në dijeni të përgjegjësisë në tërësi. Andaj, në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë nuk mund të arsyetoj faktin se palët me marrëveshje jashtë gjyqësore e kanë rregulluar

çështjen e kompensimit, pasi që me provat e administruara është konstatuar se përgjegjës i vetëm për shkaktimin e dëmit është i siguruari i të paditurës dhe në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është dashur të veproj konform përgjegjësisë së përcaktuar nga eksperti i komunikacionit dhe të vendos në lidhje me kërkesën e paditësve për 50% të përgjegjësisë së pa zgjidhur. Andaj duke qenë se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plot, ka ardhë deri ta zbatimi i gabuar i të drejtës materiale. Andaj, nisur nga kjo gjendje e çështjes, gjykata e Apelit e aprovon në tërësi si të bazuar ankesën e paditësve dhe çështjen e kthen në ri procedurë dhe ri vendosje.

Në ri procedurë, udhëzohet gjykata e shkallës e parë që të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, ashtu që pasi të konstatoj se janë plotësuar të gjitha kushtet procedurale për vendosje në këtë procedurë, të administroj prova për vërtetimin e drejt dhe të plot të gjendjes faktike, të thërret ekspertin e komunikacionit e qëllim të sqarimit të ekspertizës së komunikacionit për ti eliminuar dilemat në lidhje me bazën juridike, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për vërtetimin e lartësisë së dëmit pa u fokusuar tek marrëveshja jashtë gjyqësore e arritur mesë palëve, të kujdeset që dispozitivi i aktgjykimit të jetë në harmoni juridike dhe logjike me arsyetimin dhe të kujdeset që dispozitivi të jetë i ekzekutueshëm. Krejt në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e vendosjes për bazueshmërinë e kërkesë padisë së paditësit të aplikoj drejtë edhe të drejtën materiale, në mënyrë që të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 pika c), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

A.C.nr.6244/2021 datë 22.02.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v